



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. **66**

Prishtinë, më 23.4.2012, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-10

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Liburn Aliu, Rasim Demiri, Nijazi Idrizi, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri,

Mungoi : Daut Haradinaj, Salih Morina, Etem Arifi.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: zyrtar nga MMPH (Arben Çitaku, Remzush Latifi dhe Naser Bala), bashkëpunëtor, përfaqësues dhe vëzhgues të interesuar (ICO, KDI, OSBE, Presidenca) dhe media.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës ;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 17.4.2012,
3. Shqyrtimi i Projektligjit për Agjencinë e Kosovës për mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore,
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 17.4.2012

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 17.4.2012 me disa plotësime dhe vërejtje të cilat do të bashkëngjiten pas transkriptimit të dëgjimit publik. Komisioni konstatoi se është e papranueshme të ndermírën masat e caktuara (largim nga puna në MTI) ndaj personave të ftuar në dëgjim publik, ngase i ftuari është ftuar nga komisioni si individ

të jap mendimin. Nëse ka nevojë, komisioni prapë do të reagoj lidhur me personat e ftuar në dëgjim publik, ngase në këtë dëgjim publik së pari kanë referuar përfaqësuesit institucional, pastaj është kaluar në individ veç e veç.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për Rrezatime

Kryetari Nait Hasani njoftoi komisionin për reagimet nga MMPH pas mbledhjes së datës 11.4.2012 kur është vendosur nga komisioni për kthimin e projektligjit për agjencinë e rrezatimeve, ndaj ftoi përfaqësuesin e MMPH z. **Arben Çitakun** të njoftoi me qëndrimet zyrtare në këtë ministri, i cili konfirmoi ndryshimin e qëndrimit të MMPH për vendin ku do të ketë kjo agjenci, dhe propozoi të votohen amendamentet e ndryshuara duke shtuar se **kapacitetet e formuara administrative brenda MMPH lidhur me këtë agjenci mbesin në këtë ministri ngase kanë kontrata me Ministrinë, ndërsa pranë ZK krijohet obligimi që Agjencia të hap vendet e reja të punës. Liburn Aliu** mbeti pranë qëndrimit se kjo Agjenci duhet të jetë në kuadër të MMPH dhe nuk votoi për ato amendamente që përkrahin këtë transfer të Agjencisë pranë ZK, përveç 4 amendamenteve të fundit, ndërsa **Kryetari** japi disa sqarime rreth iniciativës së Ambasadës Amerikane, zyrtarët e së cilës kanë biseduar me zyrtar të MMPH për këtë transfer të agjencisë në ZK, procedoi amendamentet, të cilat u miratuan për procedimin e tyre tek komisionet e përhershme dhe në Kuvend, si vijon :

Amendamenti 1

Neni 1, riformulohet si vijon:

1. **Me këtë ligj, themelohet Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore, si Agjenci ekzekutive e Qeverisë përkatësisht Zyrës së Kryeministrit.**
2. **Ky ligj përcakton statusin detyrat dhe përgjegjësitë e Agjencisë së Kosovës për Mbrojtjen nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore, si dhe hartimin dhe zbatimin e strategjisë dhe planit të veprimit për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguria bërthamore.**

Amendamenti 2

Neni 2, fshihet nënparagrafi 1.4

Amendamenti 3

Neni 4, paragrafi 1, ne rreshtin e pare fjala “Kuvendi” zëvendësohet me “**Qeveria**”.

Neni 4

Paragrafi 1 riformulohet si në vijim:

Agjencia i Kosovës për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguria bërthamore është program i veçantë buxhetor në kuadër të buxhetit të Zyrës së Kryeministrit. Buxheti i AKMRrSB-së shqyrtohet dhe miratohet në procesin e rregullt buxhetor, në pajtim me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

Amendamenti 4

Neni 6

Paragrafi 1, në fund të këtij paragrafi të shtohet teksti si në vijim:

“, sipas mundësive buxhetore të lejuara me Ligjin Vjetor të Buxhetit. “

Paragrafi 2, në fund të këtij paragrafi të shtohet teksti si në vijim:

“, sipas mundësive buxhetore të lejuara me Ligjin Vjetor të Buxhetit. “

Amendamenti 5

Neni 7, në paragrafin 1 si dhe në tërë tekstin e projektligjit fjala “Drejtori” zëvendësohet me “Kryeshefi”.

Paragrafi 2 i nenit 7 riformulohet si vijon: **“Detyrat dhe përgjegjësitë e Kryeshefit të Agjencisë caktohen me akt nënligjor të veçantë”**

Amendamenti 6

Neni 8, riformulohet :

Neni 8
Kryeshefi i Agjencisë

Kryeshefi i Agjencisë emërohet sipas Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores nr.06/2012 për pozitat e larta drejtuese në shërbimin civil të Republikës së Kosovës.

Amendamenti 7

Neni 11, paragrafi 2 fshihet.

Amendamenti 8

Neni 12, riformulohet :

Agjencia përmes Qeverisë, paraqet raport vjetor të punës për vitin paraprak në Kuvendin e Republikës së Kosovës, më së voni deri më datën 31 mars.

Amendamenti 9

Fshihet Kreu III me Nenet 13 dhe 14.

Kreu IV behet Kreu III.

Amendamenti 10

Neni 16, paragrafi 4 riformulohet :

Në raportin vjetor të Agjencisë raportohet edhe për ecurinë e zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore.

Amendamenti 11

Neni 19

Paragrafi 1, në rreshtin e tretë pas fjalës “bërthamore” shtohen fjalët “**sipas mundësive buxhetore të lejuara me Ligjin Vjetor të Buxhetit**”

Amendamenti 12

Pas Nenit 22, shtohet neni 23 :

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohen neni 6 dhe neni 7 të Ligjit nr. 03/L-104 për mbrojtje nga rrezatimi jo-jonizues, jonizues dhe sigurinë nukleare.

4. Të ndryshme, dhe emërimi i ekspertëve për projektligjet në procedurë

Në këtë pikë sipas kryesimit të **Nait Hasanit**, komisioni shqyrtoi dhe mori qëndrimet si vijon :

- **Të vizitohet Gjakova** ditën e premte më 27.4.2012 në orën 10,00 (sipas iniciativës së deputetes Sevdije Lama) me çka komisioni përkatësisht GP vazhdon monitorimin e Ligjit për VNM me kryesimin nga Liburn Aliu i cili duhet të prezantoi tek stafi për të hartuar agjendën e vizitës, si dhe duhet të njoftohet MMPH për të marr pjesë në këtë vizitë. Nait Hasani shfaqti dyshimin për lejimin e korrupsionit nga MMPH lidhur me eksploatimin e zhavorrit për shkak të siç u tha “fraksionit 01”, me çka futet rëra nga vendet tjera ilegalisht (Nijazi Idrizi), këtë duhet ta bëjnë vetëm kompanitë e licencuara (Liburn Aliu), mirëpo Arben Çitaku njoftoi komisionin lidhur me të dhënat e fundit rreth vendimit të Qeverisë për eksploatimin e rërës dhe zhavorrit dhe u obligua të dërgoi komisionit zyrtarisht memorandumun në bazë të cilit tani merr pjesë në implementim edhe një shoqatë për zhavorr dhe mund të thuhet se qëllimi i Qeverisë është arritur në një masë të caktuar ngase trendi negativ është arritur të ndalet (në pyetje janë 28 kompani prej të cilave 26 kanë pasur shkelje të licencës). Ai shtoi se do ta dërgoi edhe listën e të licencuarëve. Nait Hasani kërkoi nga MMPH një takim për javën e ardhshme për tremujorin e parë të vitit.
- Konfirmimi për ekspertët rreth projektligjeve në procedurë do të bëhet me vendime veç e veç nga komisioni më 30.4.2012, ndërsa sot prezantuan ekspertët Izet Osmanaj, Haki Tahiruka dhe Fatos Lajçi rreth projektligjit për Sharrin dhe Bjeshkët e Nemuna. Mbeti diskutabile a do të emërohet në cilësinë e juristit z. Elton Tota për shkak të definimit të marrëdhënieve në kuadër të NDI si mbështetës i komisionit. Sevdije Lama nuk miratoi sugjerimet sipas të cilave ky rajon ka më pak pyje ose më shumë si dhe rekomandimet për ekspert, ndaj deklaroi se tërhiqet nga GP për këto dy projektligje.
- Grupi punues për pasurimin e miellit emërohen : **Nait Hasani, Afërdita Berisha, Liburn Aliu dhe Sevdije Lama** ndërsa z. Agron Gashi nga UNICEF njoftoi se nga ky komision

ftohet për 12 qershor një përfaqësues (kryetari i komisionit) në punëtorinë që mbahet në Stamboll. Nijazi Idrizi konstatoi se në këtë projekt duhet të kristalizohen disa gjëra, ndërsa zyrtarët nga UNICEF sugjeruan një takim pune për ditën e enjte më 26 prill.

- Për **Projektligjin për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për bujqësi dhe zhvillim rural** u sugjerua që nuk ka nevojë për ekspert ngase propozohet të themelohet shërbimi i pagesave, ndaj komisioni mund të përfundoj këtë projektligj bashkërisht me zyrtarët e ministrisë. Grupi punues është Nijazi Idrizi, Salih Morina, Nait Hasani dhe Etem Arifi.
- **Projektligji për bujqësinë organike** do të shqyrtohet nga Eksperti Zenel Bunjaku, ndërsa grupi punues drejtohet nga Nijazi Idrizi.
- Për **Projektligjin për Ndërtimet** u konstatua se tërë komisioni është në cilësinë e GP, ndërsa u sugjeruan ekspertët Eljesi Surdulli dhe Feti Selmani të cilët ftohen për mbledhjen e radhës të sjellin CV e tyre.
- Kryetari Nait Hasani njoftoi se këtë javë nuk gjendet në Kosovë, komisioni do të vizitoi Gjeorgjinë në javën e dytë të muajit maj 2012 dhe Bullgarin (ende nuk dihet saktë data).

Mbledhja përfundoi në orën 12,45

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani